



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:291420

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06326252

KF.nr.252/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit N.T.P. “Albi Moni”, me numër unik identifikues 810428038, dhe seli në Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Granit Vokshi, avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Koci & Vokshi”, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 55,959.51 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Granit Vokshi avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 02.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P., “Albi Moni”, me seli në Podujevë.
- II. ANULOHET vendimi nr.361/2021 i datës 16.11.2021 i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, N.T.P., “Albi Moni”, me seli në Prishtinë të ia kthejë shumën prej 55,959.51 euro në emër të obligimeve tatimore shtesë dhe ndëshkimeve për mos deklaram dhe mos pranimit të shpenzimeve të transportit të dokumentuar në DUD, edhe atë për periudhën 2016-2018, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 24.12.2021, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.361/2021 i datës 11.11.2021, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar juridikisht dhe faktikisht kërkesëpadia dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar. Në seancën e shqyrtimi gjyqësor kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se e kemi pranuar ekspertizës financiar të punuar nga eksperti financiar Dr. K.R. dhe me të njëjtë pajtohem në tërësi duke theksuar se e njëjta është punuar në mënyrë profesionale, i ka hedh dritë të gjitha çështjeve kontestimore që rrjedhin nga aktvendimi i kontestuar dhe ka vërtetuar se të gjitha pretendimet e paditësit lidhur me paligjshmëritë e aktvendimit kontestues janë të bazuar. Ndërsa në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadiës të dorëzuar në këtë seancë kanë kërkuar që të aprovohet në tërësi si e themeltë padia, të anulohet vendimi kontestues dhe të obligohet e paditura që paditësi t'ia kthej shumën e përgjithshme prej 55,959.51 euro, të paguara nga paditësi në emër të obligimeve tatimore shtesë dhe ndëshkimeve për mos deklarim, si rezultat i aplikimit të vlerës së hapur të tregut në mënyrë të padrejtë dhe mospranimit të shpenzimeve të transportit të dokumentuar në DUD dhe ate për periudhën tatimore 2016-2018, të gjitha këto me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, në lidhje me se secilën muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës ashtu siç është precizuar . Vendimi kontestues është i pa mbështetur në prova dhe në ligj, ashtu siç është vërtetuar edhe nëpërmjet aktgjykimit A.nr.714/2019 e paditura në mënyrë arbitrare e ka aplikuar vlerën e hapur të tregut në produkte të caktuara të shitura nga paditësi. Ashtu siç është argumentuar edhe në padi VHT si institut mund të përdoret vetëm në rastet përjashtuese atëherë kur ka dyshime se ka nën deklarim të pa arsyeshëm të çmimit të shitjes së produkteve, ndërsa që nën deklarimin si rregull duhet të jetë në çmim më të ultë se çmimi i blerjes. Rastin konkret ashtu siç është vërtetuar edhe nga ekspertiza ku është bërë analizë e të gjithë dokumentacionit për mallrat kontestues me çmimet e rivlerësuar nga e paditura, eksperti ka paraqitur në mënyre tabelare çmimet blerëse dhe të shitjes të produkteve të kontestuara dhe ka vërtetuar se në asnjë rast çmimi i shitjes nuk ka qenë më i ultë se çmimi i blerjes. Nëpërmjet aktvendimit kontestues e paditura tenton të hyjë në stërgjinë afariste

të paditësit rreth përcaktimi të çmimeve. Në disa raste mund të ekzistojë mundësia që disa produkte të kenë çmim me marzhë më të ultë të shitjes, në krahasim me të tjerat për të arritur deri te konkludime te sakta duhet të bëhet analiza e çmimeve blerëse dhe shitëse të të gjitha produkteve e të cilën gjë e ka bërë në mënyrë të saktë ekspertiza. Sipas ekspertizës që është në linjë edhe me argumentet e paditësit në krahasim me kompanitë konkurrenente paditësi në fakt del të jetë më i shtrenjtë në ofertën e përgjithshme për ndërtimin e një shtëpie, dhe atë me vet kompanitë të cilat e paditura i ka marrë si referencë në përcaktimin e çmimit sipas vlerës së hapur të tregut, pra sipas ekspertizës në disa produkte kontestuese paditësi del që të njëjtat i ka shitur edhe më shtrenjtë se subjekti "Shkëlqimi" Shpk, pra për të përmbledhur se e paditura ka aplikuar në mënyrë të padrejtë vlerën e hapur të tregut ngase përveç faktit që çmimet e shitjes kanë qenë më të larta se çmimet e blerjes, e paditura as nuk e ka saktësuar bazën ligjore mbi të cilën është aplikuar VHT, ngase neni 24 par 8 i ligjit për TVSH ka paraparë kushte dhe kritere precize kur mund të aplikohet ky institut. Edhe sa i përket pikës tjetër kontestuese që ndërlidhet me mos pranimin e shpenzimeve të evidentuara në DUD të njohura nga Dogana e që kanë të bëjnë me KMSH-në këto janë shpenzime të transportit dhe lidhen e drejtpërdrejtë me afarizmin e paditësit. Është krejtësisht paradoksale që të mos njihet si shpenzim transporti i cili është i dokumentuar në çdo formë të kërkuar ligjore, është pikërisht neni 15 i ligjit për të ardhura personale dhe vendimi shpjegues nr. 03/16 i ATK ai i cili e sqaron kundërligjshmërinë e veprimit të paditurës. Andaj duke u bazuar në të gjitha këto dhe pas analizimit të gjitha provave dhe argumenteve kërkojmë nga gjykata që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë si të bazuar.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 29.04.2024, ka kundërshtuar pretendimin e paditësit lidhur me aplikimin e vlerës së hapur të tregut nga ana e kontrollit se është i pa drejtë dhe i pa bazuar. Më tej ka theksuar se ATK-ja DA-ja, konstaton se kontrolli bazuar në dispozitat ligjore gjegjësisht në nenin 24 të Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, paditësi ka nënvlerësuar çmimin e shitjes për personat e pa identifikuar gjegjësisht shitjet me kuponë fiskal. Ndërsa lidhur me pikën kontestuese për mos pranimin e shpenzimeve të transportit në DUD-at doganor për periudhat e kontrollit, DA-ja në bazë të raportit të kontrollit ka vërtetuar se këto e mallrave të shitur nga tatimpaguesi është deklaruar sipas DUD-it doganor, ku në përlllogaritjen e KMSH-së tatimpaguesi ka përfshirë vlerësimin doganor për shpenzimet e transportit në importimin e mallrave ku tatimpaguesi me kamionët e vet ka bërë transportimin ku ka marr zhvlerësimin e kamionëve,

shpenzimet e punëtorëve-shoferëve si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me transportin e mallrave të importuara.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditura e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 01.10.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Po ashtu me këtë parashtesë e ka njoftuar gjykatën se e kundërshton ekspertizën në tërësi, meqë e njëjta bazohet vetëm në një anë të medaljes e po ashtu konsideron si të vetmin dokument burimor e valid të dhënat që shkojnë në favor të paditësit, pa marr parasysh edhe faktet, rrethanat dhe dokumentacionin kontabël në bazë të së cilës ka vendosur meritorisht e paditur ATK, rrjedhimisht duke mos vlerësuar drejtë dhe saktë lidhur me përcaktimin zyrtar të ATK-së, meqë bazuar në faktet dhe dëshmitë e ofruar paditësi nuk ka ofruar prova që ATK-së të vepronte ndryshe nga përcaktimi zyrtar si në kontroll dhe në vendimin ku konstatohen dhe vërtetohen në mënyrë të argumentuar të gjitha të gjeturat e ekzaminimit tatimor të kryer te paditësi. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.361/2021 i datës 16.11.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 02.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendim nr. 582/2019 datë 19.02.2019, Aktgjykim A.nr.714/19 datë 03.06.2021, Përgjigje në padi datë 29.04.2024, Vendim nr. 361/2021 datë 16.11.2021, Vendimi i ZGJONA nr2208/2018 datë 23.11.2018, Përgjigje nga ATK e datës 13.02.2019, Kërkesë e datës 12.02.2019, Informatat nga palët e treta, Raporti i kontrollit 21.11.2018, Ekspertiza financiare e datës 23.07.2024 dhe Gjendja e borxheve datës 17.04.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka kryer kontroll tek paditësi me datë 21.11.2018, ku objekt kontrolli ka qenë Tatim mbi Vlerën e Shtuar për periudhën 01.01.2016-31.07.2018, Tatim në të Ardhura Personale për periudhën 2016 dhe 2017, CI për periudhën 01.01.2016-31.07.2018. Po ashtu nuk janë kontestuese edhe faktet se paditësi pas pranimit të Njoftim Vlerësimeve me datë 21.12.2018 ka parashtruar ankesë në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 19.02.2019 ka marrë vendimin nr.582/2019, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazë ankesën nr.582/2018 të datës 21.12.2018 ndërsa Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë dhe ndëshkimet të caktuara me kontroll i konfirmon si të bazuara, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 11.12.2019, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatë. Po ashtu jo kontestues janë edhe faktet se Gjykata Themelore në Prishtinë ka marr aktgjykim A.nr.714/19 të datës 03.06.2021 me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar vendimin nr.582/2018 të datës 19.02.2019 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të e paditura. Administrata Tatimore e Kosovës në rivendosje ka marr vendimin nr.361/2021 të datës 16.11.2021 ai akt administrativ përfundimtar me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 24.11.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën ndërsa Njoftim Vlerësimet e Tatimi Shtesë i ka vërtetuar si të bazuar, me arsyetim se DA-ja konstaton se kontrolli në mbështetje të nenit 24, të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-në ka zbatuar vlerën e hapur të tregut sa i përket këtyre tre artikujve pasi që ka konstatuar se tatimpaguesi ka nënvlerësuar çmimin e shitjes për personat e paidentifikuar- gjegjësisht shitje me kuponë fiskal. Ndërsa kontesti i tatimpaguesit se kontrolli nuk ka pranuar shpenzimet e transportit në DUD-at Doganor, për periudhat e kontrolli, DA-ja konstaton se tatimpaguesi nuk ka të drejtë në këtë pikë pasi që kontrolli në mbështetje të UA nr.03/2016, veprimtaria e të cilëve është lidhur me importin e mallrave dhe pajisjeve, në rastet kur këto importe i nënshtrohen vlerësimeve apo ri vlerësimeve Doganore nenin 15, paragrafi 1 i Ligjit nr.05/L-028 për TAP-ë. Po ashtu DA-ja në bazë të raportit të kontrollit ka vërtetuar se kostot e mallrave të shitur nga tatimpaguesi është deklaruar sipas DUD-it doganor ku në përlllogaritjen e KMSH-së

tatimpaguesi ka përfshirë vlerësimin doganor për shpenzimet e transportit në importimin e mallrave, transporti i mallrave ishte bërë nga vetë tatimpaguesi me kamionët e vetë ku tatimpaguesi kishte marr zhvlerësimin e kamionëve, shpenzimet e punëtorëve-gjegjësisht shoferëve si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me transportin e mallrave të importuara. Bazuar në shpjegimin publik nr.03/2016 ky vlerësim doganor nuk duhet të përlllogaritet si kosto e mallrave të shitur ngase kemi dyfishim të shpenzimeve të atyre të ndodhura dhe atyre të përlllogaritura nga Dogana e Kosovës, andaj me kontroll të njëjtat nuk janë pranuar, pasi që janë shpenzimet reale, si shpenzimet e derivateve, shpenzimet e punëtorëve sigurimeve të automjeteve, shpenzimet e zhvlerësimit, ndërsa vlera e përcaktuar nga Dogana me kontroll për shpenzimet e transportit janë eliminuara nga kosto e mallrave të shitur në mbështetje të nënti 15 të Ligjit nr,05/L-028 për TAP dhe Vendimi Shpjegues Publik nr.03/2016

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të përfaqësuesit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.252/22 të datës 28.05.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar-administrativ me ekspertin financiar K.R., me detyra përkatëse si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga mendimi dhe konstatimi i nxjerrë i ekspertit financiar në ekspertizën financiare ka konstatuar se: *“Duke u bazuar në dokumentet e analizuara mendoj se ATK pa të drejtë e ka përdoruar vlerën e hapur të tregut , pasi që bazuar në Ligjin nr.03/L-222 nuk është plotësuar asnjë nga kriteret për të aplikuar vlerën e hapur të tregut, pastaj duke u bazuar në faturat e shitjes ku çmimet e shitjes janë më të larta sesa çmimet e bërjes të cilat janë përlllogaritur duke u bazuar në DUD dhe faturat e furnitorëve si dhe duke e ditur se në ekonominë e tregut çmimet mund të jenë fleksibile”*. Po ashtu sa i përket shpenzimeve të papranuara të transportit të dokumentuara në DUD mendoj se ATK është dashur që të bëjë: 1. Pranimin e shpenzimeve të transportit sipas DUD-it ose 2. Pranimin e shpenzimeve të derivateve të cilat nuk kanë qenë të deklaruara për shkak të mos dyfishimit të shpenzimeve, si KMSH. Prandaj unë mendoj se duhet të pranohen njëra nga llojet e shpenzimeve ose vlera e dokumentuara në DUD ose faturat e derivateve sepse kamionët transportues kanë shpenzuar derivate të cilat janë të faturuara me fatura dhe pagesa ku të njëjtat i janë ofruar ATK-së gjatë procedurës së kontrollit. Duke u bazuar në përlllogaritjet e bëra kam konstatuar se paditësi

ka paguar pa të drejtë tatim shtesë dhe ndëshkim për mos deklarim të kalkuluar nga ATK në vlerë 55,959.51 euro.”

Në seancën në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 02.10.2024 eksperti financiar K.R. ka deklaruar se: *“Qëndroj pranë ekspertizës të cilën e kam dorëzuar me datë 23.07.2024 sipas dokumentacionit të pranuar nga paditësi. Kam ardhur në përfundim se paditësi është ngarkuar ma tatim shtesë padrejtësisht në dy pika: te vlera e hapur e tregut dhe mos pranimi i shpenzimeve të transportit të mallit të deklaruar me DUD-in doganor. Sa i përket vlerës së hapur të tregut e përcakton qartë Ligji 03/L-222 ku asnjë nga pikat e caktuara të këtij ligji nuk janë plotësuar për të aplikua vlerën e hapur të tregut. Ndërsa te shpenzimet e transportit kanë qenë të evidentuara në DUD prandaj i kam njohur si shpenzime”.*

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 23.07.2024 të punuar nga eksperti financiar K.R., në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.714/2019 datë 03.06.2021, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në aktvendimin e parë refuzues me nr.582/2018 të datës 19.02.2019 ka dhënë arsytim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështetur vendimin e kontestuar edhe në aktvendimin tani kontestues nr.361/2021 të datës 16.11.2021

Ligjin Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 24 par 2 përcakton se: *“Për nevoja të këtij ligji “vlera e hapur e tregut” nënkupton shumën e plotë që duhet ta paguaj konsumatori në shkallën e njëjtë të tregut në të cilin ndodh furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, nën kushtet e konkurrencës së barabartë, për furnizuesin nën mbizotërimin e tregut brenda Kosovës ku është bërë furnizimi, në mënyrë që të marr mallrat ose shërbimet në fjalë në atë moment.”*

Gjykata përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare gjeti se ATK pa të drejtë e ka përdorur vlerën e hapur të tregut për arsye se, bazuar në Ligjin Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, nuk është plotësuar asnjë nga kriteret për të aplikuar vlerën e hapur të tregut, po ashtu duke u bazuar në faturat e shitjes ku çmimet e blerjes të cilat janë përlllogaritur duke u bazuar në DUD dhe faturat e furnitorëve si dhe duke e ditur se në ekonominë e tregut çmimet mund të jenë fleksibile, ngritja e çmimeve të shitjes për artikujt të caktuar nga ana e ATK-së është e padrejtë. Nga gjetjet e ekspertizës financiare konstatohet se dy nga konkurrentet të cilët i ka marr për bazë e paditura gjenden jashtë komunës së Podujevës dhe të njëjtit nuk i plotësojnë kushtet për të bërë krahasimin pasi që në ofertë shpenzimet e transportit mund të jenë shumë më të larta në raport me konkurrentet në territorin e Podujevës. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të papranuara të transportit të dokumentuara në DUD, e paditura është dashur që të bëjë pranimin e shpenzimeve të transportit sipas DUD-it ose pranimin e shpenzimeve të derivateve të cilat nuk kanë qenë të deklaruara për shkak të mos dyfishimit të shpenzimeve, si KMSH. Andaj duhet të pranohen njëra nga llojet e shpenzimeve ose vlera e dokumentuara në DUD ose faturat e derivateve sepse kamionët transportues kanë shpenzuar derivate të cilat janë të faturuara me fatura dhe pagesa ku të njëjtat i janë ofruar ATK-së gjatë procedurës së kontrollit.

Tutje, Gjykata ka vërtetuar faktin që ATK konstatimet e saj në vendimin e kontestuar nuk i mbështet në asnjë dokumentacion dhe me ndonjë fakt, andaj edhe arsyetim i vendimit kontestues është i pabazuar dhe është i barabartë me mungesë të tij.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK ka nxjerr konkluzion jo të drejt në pikëpamje të gjendjes faktike edhe atë lidhur me aplikimin e vlerës së hapur të tregut, si dhe shpenzimeve të papranuara të transportit të dokumentuar në DUD, prandaj Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par 3 dhe 46 par. 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet

Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin kontestues dhe e detyroj të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit që paditësit, N.T.P., “Albi Moni”, me seli në Prishtinë të ia kthej shumën prej 55,959.51 euro në emër të obligimeve tatimore shtesë dhe ndëshkimeve për mos deklarim dhe mos pranimit të shpenzimeve të transportit të dokumentuar në DUD, edhe ate për periudhën 2016-2018, me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së vendimit të nxjerr nga e paditura e deri në pagesën definitive.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruaragjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke aplikuar e dispozitën e nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore

dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Kjo për faktin se paditësi pretendimet e veta siç u vlerësuar edhe më lartë i ka të bazuara në fakte, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për tu njohur si të tilla.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitë nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.252/22 datë 02.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.